



Nivelet e gjuhës sipas GER (Kuari i Referencave të Përbashkëta Evropiane)

Kuari i referencave evropiane (GER) i ndan të gjitha testet evropiane të gjuhës në 6 nivele vështirësie, për të bërë kështu të krahasueshme ofertat që vijnë nga burime të ndryshme.

Përdorimi elementar i gjuhës A1	Pasi ka marrë provimin e A1 ai është në gjendje:
<p>Personi mund të kuptojë dhe përdorë shprehje bazë të përditshme dhe fjali shumë të thjeshta të cilat synojnë plotësimin e nevojave konkrete. Ai mund të prezantojë veten dhe të tjerët si dhe mund të pyesë personat e tjerë për informacione personale p.sh ku jetoni, çfarë njerëzish njihni ose çfarë gjerash kenë – si dhe mund t'ju japë përgjigje pyetjeve të kësaj natyre. Ai mund të kuptohet me persona të tjerë duke përdorur një gjuhë të thjeshtë, nëse bashkëbiseduesi ose bashkëbiseduesja flasin ngadalë dhe qartë dhe janë të predispozuar për të ndihmuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë pyetje, fjali dhe mesazhe të shkurtra dhe shumë të thjeshta në situata të përditshme, si dhe mesazhet zanore në telefon, njoftimet publike si dhe bisedat e shkurtra • relevante Informacionen nga mesazhe të shkruara, tabela publike dhe njoftime të shkurtra. • Ai mund të shqiptojë dhe të kuptojë numra, sasi, orën dhe çmime. • Mund të plotësojë formularë me të dhëna personale të thjeshta. • Mund të shkruajë mesazhe personale të shkurtra. • Mund të prezantohet dhe tu përgjigjet pyetjeve të thjeshta mbi personin e tij. • Mund të formulojë pyetje dhe lutje të zakonshme ne jetën e përditshme si dhe të reagojë në lidhje me to.
Përdorimi elementar i gjuhës A2	Pasi ka marrë provimin e A2 ai është në gjendje:
<p>Mund të kuptojë fjali dhe shprehje që përdoren shpesh dhe që kanë lidhje me kontekstin (p.sh informacion mbi personin dhe familjen, blerjet, punën, mjedisin përreth). Mund të komunikojë në situata të thjeshta rutinë, kur është fjalë për një shkëmbim të thjeshtë dhe direkt informacioni mbi çështje të thjeshta dhe rutinore. Si dhe mund të përshkruajë me fjalë të thjeshta prejardhjen apo arsimimin e tij, ambientin apo sendet që lidhen me nevojat e tij të drejtpërdrejta.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë informacionet më të rëndësishme në bisedat e përditshmepor edhe shprehje të shkurtra nga radioja ose mesazhet nga telefoni. • Të nxjerrë dhe të kuptojë informacionet më të rëndësishme nga artikujt e shkurtër • Të plotësojë formularë të zakonshëm në dyqane, banka apo zyra. • Te shkruaje mesazhe, qe lidhen me mjedisin rrotull • Të prezantohet të shkëmbejë informacione mbi situatat vetjake jetësore. • Të bëjë pyetje dhe tu përgjigjet pyetjeve që lidhen me temat e jetës së përditshme • Të diskutojë dhe të negociojë mbi tema dhe biseda të përditshme(takime etj.).
Të plotësojë formularë të zakonshëm në dyqane, banka apo zyra B1	Pasi ka marrë provimin e B1 ai është në gjendje:
<p>Mund të kuptojë pikat kryesore, nëse përdoret një gjuhë e qartë standarde dhe nëse bëhet fjalë për situata të njohura nga puna, shkolla, koha e lirë etj. Mund të vlerësojë shumicën e situatave me të cilat mund të ndeshet personi në fjalë në përditshmërinë e tij. Mund të shprehë me fjalë të thjeshta mendimin e tij mbi tema të njohura si dhe mund të shprehë interesat e tij personale. Mund të japë informacion mbi eksperiencën dhe ngjarje të ndryshme, mund të përshkruajë ëndrra, dëshira dhe qëllime si dhe mund të japë arsye të shkurtra ose sqarime mbi plane apo qëndrime të caktuara të tij.</p>	<p>Pasi ka marrë provimin e B1 ai është në gjendje p.sh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mund të kuptojë informacione të rëndësishme edhe detaje nga biseda, njoftime publike • apo njoftime në radio që i përkasin situatave të përditshme. • Mund të kuptojë meezaktësi informacione të rëndësishme nga tekstet e gazetave, statistika dhe nga përshkrime që i referohen përditshmërisë. • Mund të shkruajë mesazhe si letra apo e-maile private apo gjysmë formale në varësi të kontekstit. • Mund të bëjë një bisedë të thjeshtë mbi një temë të caktuar që lidhet me interesat e tij personale, mund të shprehë shkurtimisht mendimin e tij mbi këtë temë dhe të reagojë në mënyrë adekuate mbi mendimin e bashkëbiseduesit



Të plotësojë formularë të zakonshëm në dyqane, banka apo zyra

B2

Mund të kuptojë idetë kryesore të teksteve komplekse dhe temave abstrakte; është në gjendje të kuptojë edhe bisedat teknike që lidhen me fushën e specialitetit të tij. Mund të kuptohet në mënyrë spontane dhe të rrjedhshme me të tjerët, kështu që kryerja e një bisede normale me një person që flet gjuhën e nënës do të ishte e mundur pa sforco të mëdha nga asnjëra palë. Mund të shprehë në mënyrë të qartë dhe të detajuar mendimin e tij mbi një tematikë me spektër të gjerë, është në gjendje të sqarojë qëndrimin e tij mbi një çështje aktuale si dhe të japë avantazhet dhe disavantazhet e alternativave të ndryshme.

Përdorimi i gjuhës në mënyrë kompetente

C1

Mund të kuptojë një gamë të gjerë tekstesh të gjata dhe të sofistikuara si dhe të kapë domethëniet e tyre të nënkuptuara. Mund të komunikojë në mënyrë spontane dhe të rrjedhshme pa rënë në sy nëse është duke kërkuar shpesh fjalë të caktuara. Mund të përdorë gjuhën në mënyrë efektive dhe fleksible në jetën shoqërore ose profesionale apo në trajnime dhe studime të ndryshme. Mund të shprehë mendimin e tij në mënyrë të qartë, të mirë-strukturuar dhe të detajuar mbi tema të ndërlikuara si dhe të përdorë mjete të ndryshme gjuhësore për të lidhur tekstet në varësi të situatave.

C2

Praktikisht ai/ajo mund të kuptojë pa problem çdo gjë që lexon apo dëgjon. Mund të përmbledhë informacione nga burime të ndryshme qofshin këto me shkrim apo me gojë si dhe të riprodhojë arsyetime apo sqarime që lidhen me situata të caktuara. Mund të shprehet në mënyrë spontane, shumë rrjedhshëm dhe qartë si dhe është në gjendje që edhe në çështje të ndërlikuara të sqarojë domethëniet e detajuara të shprehjeve të veçanta.